

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e gjyqtarëve, Rama: Kurrë jo! Kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë ku ndër VAR-it
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/pagat-e-gjyqtareve-rama-kurre-jo-kjo-nuk-eshte-gjuhe-gjykatesi-po-gjuhe-i586102
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	unreachable

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:40:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:40:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	47f4adece82920d333825b3cc0bd3481419058f334bc481a4cdf0f8e47a3c2f1
TEKSTI	28aa3cd4e64d29aecbf5e07a26971e416acafdafc2d33ef76e8a0177ed5a5d9a
PAMJA	d5c9ff72260e690f6dd75dbe86765da067ea1c9363cd2eab6576cfdeba5b1887

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	89ea98891ec02f22cd0a89121f9823ad15787dc82ad6ac66dc5fcf739a3d671d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/89ea98891ec02f22cd0a89121f9823ad15787dc82ad6ac66dc5fcf739a3d671d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English




ie Rutte: Sulmi në trenin e Ukraines tregon se sa i "deshpëruar" është Putin/Pagat, lufta vazhdon pas 17 shtatorit/ Rexhaj: Një përpjekje e shtikuar e magistratëve për të rr fundit

Pagat e gjyqtarëve, Rama: Kurrë jo! Kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë kundër VAR-it



14 Shtator 2026, 19:40Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama ka reaguar ashpër ndaj pretendimeve të shoqatave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për rritjen e pagave, duke e cilësuar retorikën e tyre si "gjuhë ultrasi" dhe jo si qëndrim dinjitoz gjyqësor.

Rama theksoi se politika e pagave mbetet kompetencë ekskluzive e qeverisë dhe parlamentit, duke refuzuar çdo imponim apo presion përmes mjeteve juridike e politike. Pavarësisht përplasjes publike, ai nënvizoi se tryeza e dialogut ndërmjet pushteteve mbetet e hapur për gjetjen e një zgjidhjeje institucionalisht të qëndrueshme.

"E pabesueshme, po e vërtetë që një gjykatës e kupton kështu pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar..."

Kurrë jo, kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë kundër VAR-it.

Keqardhje dhe disa të vërteta të thjeshta:

Askush nuk e zëvendëson dot parlamentin dhe as nuk e urdhëron dot legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën. Vetëm Gjykata Kushtetuese e askush tjetër, ka të drejtën dhe detyrën t'i thotë se kur e ka ngritur dorën gabim, po as ajo vetë nuk i thotë dot kurrsesi pushtetit të pavarur legjislativ se si duhet ta ngrejë dorën.

Politikën e pagave e propozon vetëm qeveria, e miraton vetëm parlamenti dhe e zbaton vetëm qeveria. Gjykata Kushtetuese ndërhyr vetëm nëse cënohet një parim a një normë kushtetuese, që ligjvënësit duhet ta riparojnë pa u cënuar në pavarësinë e tyre, siç e shohin ata të udhës të shprehen me votën e tyre.

Nëse largqoftë, shoqatat e prokurorëve e të gjykatësve kanë vendosur që me mjete politike dhe juridike të koordinuara me zyrat e prokurorive e të gjykatave si një ushtri e rreshtuar kundër qeverisë, të na imponohen me kallzime, sigurime a përmbarime për të rritur pagat e tyre, atëherë jemi përpara një sfide të një lloji të ri, e cila nuk na tremb po na shqetëson pamasë. Por ne nuk duam të jetë kështu dhe unë nuk dua ta lejoj që të ndodhë kështu, sepse ndryshe nga si e mendon ky gjykatësi mediatik, kjo e pagave stratosferike, për ne nuk është çështje inati po sfidë shtetbërjeje europiane e Shqipërisë.

Është shumë e thjeshtë. Tryeza e përgatitjes për takimin e kërkuar dhe të anuluar vazhdon të jetë gati. Në 17 shtator mbaron vetëm ky episod i tensionuar

publikisht, që mund dhe duhet të ishte shmangur, por nuk shteron nevoja për të komunikuar mes pushteteve të pavarura. Përkundrazi, ajo nuk lindi nga episodi i pagave dhe do të jetë edhe më e madhe në çdo hap deri në anëtarësimin në Bashkimin European.

Por ne tryezën dhe gatishmërinë kemi, të tjerat janë në gjykimin e gjykatësve:-)", tha Rama.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

19:20 Politika

[Begaj takohet me homologun Mohamed bin Zayed, vizita e parë e një presidenti shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe](#)

18:10 Politika / 3 komente

Muzeu hebraik, shtegu i ri i betejës anti-amerikane pas Zvërnecit

17:57 Politika / 1 koment

Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Në thesar nuk fut dot dorën kushdo, s'i vë dot kush shkelmin parave të shqiptarëve

16:00 Politika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.